




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/52
Datë: 30.01.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 51 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/52
Datë: 30.01.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia Afatmesme e Punës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal 2009 – 2012 .
2. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal obligohet të bëjë koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e kësaj strategjie.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen edhe ministritë tjera dhe komunat varësisht prej përgjegjësive që ushtrojnë, në raport me qeverisjen lokale.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/52

Datë: 30.01.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, si dhe nenit 7 paragrafi 1, nenit 8 dhe 14 të Rregullores 01/2008 për Funkcionimin e Fondit për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve të Tjera të Veçanta, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2009, mori

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për Menaxhimin e Fondit për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve Tjera të Veçanta, në këtë përbërje:
 - 1) Përfaqësues i Zyrës për Komunikim Publik - Kryesues
 - 2) Përfaqësues i Ministrisë së Kthimit dhe Komuniteteve
 - 3) Përfaqësues i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës
 - 4) Përfaqësues i Institutit të Mediave të Kosovës
 - 5) Përfaqësues të IREX-it
 - 6) Përfaqësues nga RTK - ja, redaksia e programeve për minoritete.
2. Anëtarët e Komisionit emërohen me mandat 2 vjeçar me mundësi vazhdimi edhe për një mandat tjetër.
3. Komisioni, sipas pikës 1. të këtij vendimi, do të përkrahet nga Sekretaria e Komisionit për Menaxhimin e Fondit, e cila do të funksionojë në kuadër të Zyrës për Komunikim Publik pranë Zyrës së Kryeministrit.
4. Sekretaria do të përbëhet nga dy zyrtarë dhe udhëheqësi i komisionit i cili përveç mëditjeve që merr si anëtar i komisionit, do të marrë edhe kompensim shtesë mujor, në vlerë prej 100 (njëqind) Euro.

5. Detyrat, përgjegjësitë, si dhe kompensimi i anëtarëve të komisionit janë të përcaktuara me Rregulloren 01/2008 për Funkcionimin e Fondit për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve të Tjera të Veçanta.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë